



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 7162 Prot.

Tiranë, më: 03.9. 2018

Nr. Identifikimi 634

Vendimi 39

## DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

### VENDOSI :

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person juridik:** "SHUSHICA HYDROPOWER" sh.p.k.  
**Nr. NIPT-i:** L71729019M  
**Adresa e selise:** Rruga "Sami Frashëri", Njësia Bashkiake Nr. 5, Ndërtesa 19, Hyrja 8, Tiranë  
**Personi përgjegjës** Henri Aleksi

Për të zhvilluar projektin: "Ndërtimi i HEC-eve në pellgun e lumit Shushica"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10 440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 9, "Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis", Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure. Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike;

**Vendndodhja:** në pellgun e lumit Shushicë, Qarku Vlorë

**Të dhëna teknike të projektit:**

Fuqia e instaluar: 14.9 MW

(Bashkangjitur Aneksi 1 , gjendet gjurma e projektit.)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

*Drejtoritë Teknike në Ministrinë e Mjedisit, shprehen si më poshtë vijon:*

- Gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së subjekti nuk ka mbajtur parasysh sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Sugjerimet të reflektohen në raport të gjitha komentet e dhëna në fazën e njoftimit.
- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat, në mënyrë që të gjykohet mbi impaktin që do të ketë në fondin Pyjor dhe kullosor publik.
- Sugjerimet të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, shprehet:* Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti i "HEC Shushica" ndodhet jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk prek asnjë Monument Natyre.

### **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me Publikun:* Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve i'u siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

### **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

Zhvillimi i këtij aktiviteti zhvillohet në bazë të:

- Kontratës Koncesionit të formës BOT nga MEI me Nr. 2022 Rep. Nr. 922/3 Kol, datë: 14.09.2017, "Për ndërtimin e Kaskdës së Hidrocentraleve mbi lumin Shushicë", Qarku Vlorë.

### **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.**

**4.1** Ky aktivitet të zhvillohet në përputhje të plotë me Kontratën Konçensionare / Miratimin Paraprak, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, Leje për Shfrytëzimin e



ujit, të miratuara nga organet kompetente (KKT / Bashki / Njësi Administrative apo institucioneve të tjera) sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- 4.2 Subjekti të kryejë aktivitetin brenda koordinatave të miratuara nga autoritetet kompetente.
- 4.3 Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fondi pyjor
- 4.4 Të instalohen të gjithë agregatet e deklaruar në raportin e VNM-së ku përfshihen edhe ato që parandalojnë apo minimizojnë ndikimet në mjedis.
- 4.5 Subjekti të kryejë aktivitetin vetëm brenda koordinatave të dhëna në relacionin teknik.
- 4.6 Të forcohen brigjet e rrjedhës ujore duke mbjellë fidanë të rinj në brigjet e saj paralelisht me ndërtimin e veprës.
- 4.7 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 4.8 Ndërtimi i HEC-it të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe objekteve të tjera në afërsi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësjellësi kanale etj.
- 4.9 Për asnjë arsye të mos çenohet aktiviteti i përditshëm bujqësor i banorëve përreth, duke minimizuar kështu impaktin social.
- 4.10 Të bëhet kujdes me ruajtjen e ekosistemit ujor, duke mos çenuar në asnjë mënyrë segmentet ujore.
- 4.11 Të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe standartet, për operimin e punës brenda subjektit sipas relacionit të përshkruar në VNM.
- 4.12 Niveli i zhurmave gjatë procesit të ndërtimit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët (jo herët në mengjes dhe jo vonë në mbrëmje).
- 4.13 Të merren masat teknike dhe organizative për zbutjen e ndikimeve në mjedis të gjeneruara nga operacionet e gërmimit dhe gjenerimit të dherave.
- 4.14 Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 4.15 Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, si të ambalazhimit dhe mbetjeve inerte, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësi vendore sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.16 Të parashikohen dhe merren masa për parandalimin dhe kontrollin e ndotjeve në tokë gjatë fazës së instalimit të pajisjeve teknologjike për ndërtimin e veprave, si derdhje lëndësh ndotëse, vajra lubrifikues, graso, karburante etj.
- 4.17 Të përdoren mjete të kolauduara për ndërtimin dhe zbatimin e projekti, me qëllim evitimin e ndotjeve të mundshme si pasojë e dëmtimit apo avarie të mundshme.
- 4.18 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve;
- 4.19 Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive të bëhet vetëm brenda sipërfaqes së kampeve të ndërtimit dhe në vendin e përcaktuar;
- 4.20 Transporti i materialit inert të bëhet me mjete të pastra sidomos nga balta (të pastrohen gommat para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjetet transportuese të mbulohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e materialit në rrugë dhe emetimin e pluhrave;
- 4.21 Shërbimi i automjeteve, magazinimi ose mbajtja e mjeteve ndihmëse të punës si pjesë këmbimi për automjete, lubrifikante, goma etj. të bëhen në vende të tilla që të evitohen dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis;

